

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ UNIVERS TRAVEL” SHPK

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Statut i ri i shoqerise hartohet bazuar dhe ne pajtim me Ligjiin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", si dhe Legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 2

EMERTIMI

Emertimi i plote i shoqerise eshte " UNIVERS TRAVEL" Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar Emertimi i shkurtuar eshte "UNIVERS TRAVEL" SHPK.

NENI 3

FORMA E SHOQERISE

Shoqeria do te vijoje te kete formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar, (shkurtimisht SHPK), sipas percaktimeve te nenit 68 te Ligjit nr. 9901 date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise "Univers Travel" shpk do te jete ne Tirane, ne rrugen "Mine Peza" Pall. 1 Shk. 1.

Shoqeria, ne pajtim me legjislacionin ne fuqi, sipas nevojave te veprimtarise se vete, gezon te drejten per te hapur brenda vendit filiale, dege apo agjenci te tjera .



NENI 5

KOHEZGJTJA E SHOQERISE

Kohezgjatje e veprimtarise se shoqerise "Univers Travel" shpk do te jete edhe 10 (dhjete) vjet, duke filluar nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij statuti.

NENI 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte shitja biletave te transportit nderkombeter te udhetareve me linjat ajrore, detare e tokesore, te organizimit dhe kryerjes udhetimeve turistike brenda dhe jashte vendit per turistte vendas dhe te huaj, si dhe te komunikimit dhe dhenies se cdo informacioni qe lidhet me udhetimin dhe akomodimin e klienteve.

NENI 7

Ne pajtim me legjislacionin ne fuqi shoqeria gezon te drejten te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe mund te merren nga ortaket themelues te shoqerise.

NENI 8

THEMELUESIT E SHOQERISE

Themeluesit e shoqerise mund te jene persona fizik dhe juridik qe zoterojne teresisht ose pjese te kapitalit te shoqerise, me te gjitha menytrat e parashikuar nga ligji. Shoqeria "Univers Travel" shpk do te vijoje te jete prone nje Ortaku te Vetem. Ortak i Vetem themelues i shoqerise "Univers Travel" shpk eshte Z. Gavrosh Pogaçe.

NENI 9

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise "Univers Travel" shpk eshte 100.000 Lek (njqindmije) i investuar dhe i zoteruar ne mase te plote nga Ortaku i Vetem. Ne pajtim me dispozitat e ligjit, nese e gjykon te nevojeshme, shoqeria gezon te drejten te vendose shtimin ose pakesimin e kapitalit themeltar.



NENI 10

DREJTIMI I SHOQERISE

Organi ligjor pergjegjes dhe vendimarrës i shoqerise eshte Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve themelues.

Per shoqerine "Univers Travel" shpk te gjitha keto atributet i perkasin Ortakut Te Vetem.

Ai mbart te gjitha pergjegjesite per veprimtarine ekonomike te shoqerise brenda kapitalit te shoqerise dhe nuk pergjigjet per detyrimet e saja ndaj te treteve me pasurine e tij vetijeke .

NENI 11

ADMINISTRIMI

Ortaku i Vetem emerohet nje ose disa administrator te shoqerise te cilet ne ushtrimin e funksionit te tyre kane te gjitha te drejtat dhe detyrimet e percaktuara ne nenet 95, 96, 97, 98 te Ligjit nr. 9901 date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Administrator i shoqerise "Univers Travel" shpk emerohet z. Gavrosh Pogaçe.

NENI 12

KOHEZGJATJA E EMERIMIT

Ne pajtim me dispoziten ligjore perkatese kohezgjatja e emerimit te Administratorit te shoqerise "Univers Travel" shpk ne kete detyre do te jete 5 (pese) vjet me te drejte ripërteritje. Kohezgjatja e ketij emerimi percaktohen me vendimin perkates te Ortakut te Vetem Eshte e drejte e tij, qe ne çdo kohe, te vendose shkarkimin e Administratorit te shoqerise para ketij afati kur gjykon se veprimtaria e tij bie ndesh me interesat dhe politikat ekonomike te shoqerise, ose per shkaqe te tjera te parashikuara ne ligj.

NENI 13

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Administratori eshte perfaqesuesi ligjor i shoqerise para te treteve. Per kryerjen e detyrave te ngarkuara nga Asambleja e Ortakeve si dhe per zbatimin e politikave ekonomike dhe te zhvillimit te shoqerisedhe ai pergjigjet para shoqerise ne pajtim me dispozita e ligjit. Ne asnje rast ai nuk mund te marre atributet e ortakeve dhe nuk mund te kryej aktivitet konkurues te çfardolloji e per llogari te kujdo.

NENI 14

MARDHENIET E PUNES

Te gjitha mardheniet e punes ne shoqeri regullohen nepermjet kontrates se punes se perpiluar



ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

NENI 15

PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet , bashkohet, te transformohet ne lloje te tjera shoqerish si dhe mund te priset para afatit te parashikuar ne kete statut, sipas vendimit te Ortakut te Vetem, ne pajtim me modalitetet dhe procedurave te parashikuara ne ligj.

NENI 16

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Ndryshimet dhe plotesimet eventuale te ketij statute behen me te njejta procedura me te cilat eshte bere miratimi I tij
Per te gjitha çeshtjet per te cilat ky statut nuk eshte shprehur ap;likohen dispozitat e legjislacionit ne fuqi
Ky statut hyn ne fuqi ditën e vendimit te Ortakut te Vetem.

Tirane, me 10.06.2014

ORTAK I VETEM

Gavrosh POGAÇE

